



Në kuadër të Marrëveshjes KA1 bilaterale, është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët e Universitetit Politeknik të Tiranës, (Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit dhe Fakulteti i Inxhinierisë Matematike & Inxhinierisë Fizike), në University Institute of Lisbon.

**Llojet e mobilitetit përfshijnë:**

- Shkëmbimin e studentëve për studime.

**Nivelet e mobilitetit për studentët:** Tre ciklet e studimit (Bachelor, Master, Doktoraturë)

- Studentët duhet të jenë të regjistruar në Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës, Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit dhe Fakultetin e Inxhinierisë Matematike & Inxhinierisë Fizike, të Universitetit Politeknik të Tiranës.

**Kohëzgjatja e bursave për studentët:**

- Semestri i 2-të i vitit akademik 2022 – 2023

**Numri total i studentëve:** 2

**Dokumentat e nevojshme për aplikim:**

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti;
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Listë notash e studimeve, deri në momentin e aplikimit;
- Certifikatë e gjuhës së huaj\* (Anglisht);
- Dokumenti Learning Agreement\*\*.



**Key Action 1**  
**- Mobility for learners and staff -**

*\*Ofrohen kurset në gjuhën angleze, ku niveli minimal i kërkuar për gjuhën është B2. Studenti duhet të plotësojë nivelin minimal të kërkuar të gjuhës duke e vërtetuar me certifikatën përkatëse të gjuhës së huaj. Preferohen: TOEFL iBT Certificate, Cambridge Certificate, IELTS Certificate.*

*\*\*Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë ‘Mobility Plan’. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin Politeknik të Tiranës, kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

*KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në ISCTE lëndë të njëjta ose ekuivalente me ato që do të kryeni në semestrin përkatës në fakultetin tuaj, kjo për arsye që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin përkatës, atëherë kur të ktheheni ju duhet të zhvillohen lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Politeknik të Tiranës.*

*Dokumenti ‘Learning Agreement’ te seksioni ‘Commitment’ firmoset nga aplikanti, nga Shefi i Departamentit dhe nga Zv/Rektori i UPT-së për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.*

*Për të shkarkuar formatin e ‘Learning Agreement’ klikoni më poshtë:*

[ANEKS 2 - Mobility-agreement-studies, student.pdf \(upt.al\)](#)

***Afati për aplikim, pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT: Deri më 8 nëntor 2022, ora 12.00.***

Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT mund të kontaktoni në email: [rkodra@upt.al](mailto:rkodra@upt.al) dhe [abeqo@upt.al](mailto:abeqo@upt.al)